

## SKEDË TEKNIKE

### RÖFIX 672

Llaç sprucues, urë lidhëse



#### Fushat e përdorimit

Llaç çimentoje me sprucim i fortësuar dhe mjet lidhës për sipërfaqe të lëmuara të betonit, si dhe për tulla prej tallashi të presuar, pllaka prej leshi druri, muraturë prej guri natyror, si dhe përbërës të muraturave të plotë me përthithje të fortë ose me përthithje të ndryshme. Për muraturat e lehta dhe me porozitet të lartë këshillohet një llaç i lehtë paratrajtues me sprucim (si p.sh. RÖFIX 673)


#### Karakteristikat

- Shtresë bazë me kapje të mirë për suva
- Ngjitje e mirë

#### Përpunimi



#### Të dhëna teknike

Numri i artikullit	37330
EAN	9003304373307
Paketimi	
Sasi për njësi	30 kg/Nj.
Njësi për paletë	42 Nj./Pal
Madhësia e kokrrizave	0-1,4 cm
Konsumi	rreth. 4 kg/m <sup>2</sup>
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.
Prodhimi i litrave	670 L/t
Njësia e kërkesës për ujë	rreth. 5,25 L/Nj.
Reaksioni ndaj zjarrit	A1
Difuzioni i avullit të ujit	rreth. 30
Forca në lidhje	≥ 0,08 N/mm <sup>2</sup>
Forca në shtypje	15 N/mm <sup>2</sup> (28 d) EN 1015-11
Forca në përkulje	≤ 3,5 N/mm <sup>2</sup>
Përcjellshmëria termike	0,82 W/mK për P=50% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës) 0,89 W/mK für P=90% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës)

## RÖFIX 672

Llaç sprucues, urë lidhëse

Numri i artikullit	37330
Moduli-E	rreth. 13000 N/mm <sup>2</sup>
Koha e tharjes	> 3 d
Masa vëllimore e llaçit të freskët	rreth. 1750 kg/L
Trashësia minimale e suvasë	3 mm
Grup llaçi	GP EN 998-1 CS IV EN 998-1 Wc0 EN 998-1
Vlera e pH	12
Dendësia e shtresës niveluese	rreth. 1600 kg/m <sup>3</sup> EN 1097-3
Kapaciteti termik	rreth. 1 kJ/kg K
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	rreth. 1558 kg/m <sup>3</sup>
Temperatura e nënshtresës	5 °C
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.

### Baza e materialit

- Rërë gëlqerore e thërrmuar me aditiv për përmirësimin e ngjitjes
- Mineral
- Çimento

### Kushtet e punimit

Gjatë fazës së përpunimit dhe tharjes, ambjenti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C dhe të ngrihet mbi +30 °C. Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.

### Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blözë, kripra etj. . Pastrojeni nga lëndët ndarëse (dyll, vaj armature, etj). Testimi i bazamentit duhet të vijojë sipas ÖNORM B3346 ose DIN 18350 ose SIA V242. Këshillat e përpunimit vlejnjë për muret e ndëtrimit të prodhuara sipas normës dhe

me kusht fugat e mbyllura. Fugat e hapura në mur si dhe carjet, duhet të mbyllen paraprakisht me materjalin e përshtatshëm. Në rast bazamentesh kritike (si mure shumë poroze, porobeton, pllaka HWL, blloqe betoni, pllaka XPS- R etj.) duhen marrë parasysh rregullat e suvatimit RÖFIX si dhe rregullat e përpunimit të prodhuesit.

### Bazamenti-Trajtimi paraprak

Bazamentet prej suvaje me aftësi të ndryshme thithëse, kanë nevojë për një llaç sprucues RÖFIX CalceClima®, mbi të gjithë sipërfaqen. Sipërfaqet e lëmuara të betonit përgatiten me RÖFIX 672 (koha e tharjes min. 3 ditë). Kur përdorni suva me bazë shumë të fortë (p.sh. RÖFIX 620) në sipërfaqe të lëmuara betoni, RÖFIX IA622 aplikohet i freskët në i freskët. Para fillimit të suvatimit, ne te gjitha cepat duhet te jene vendosur profile suvaje te pandryshkur. Mos përdorni profile alumini për shkak të mos- rezistencës në ambiente alkaline. Përdorni vetëm profile çeliku të pandryshkshëm në pjesën e jashtme dhe në bazamente me lagështi jashtëzakonisht (ndërtim i vjetër).

## ROFIX 672

Llaç sprucues, urë lidhëse

### Përgatitja

---

Në rast punimi me dorë përzieni një thes në makinerinë përzjerese me sasinë e nevojshme të ujit, në mënyrë që të formohet një masë e njëtrajtëshme. Koha e përzierjes në rast përzierje me dorë 2 deri 3 minuta.

### Këshilla për përpunimin

---

Llaçin e freskët punojeni brenda 2 orëve. Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Në raste kushtesh të pafavorshme atmosferike (nxehësi, erë e forë) ose në rast se kemi bazamente me aftësi të lartë thithëse, bazamentin trajtoheni me ujë.

### Përpunimi

---

Në aplikimin me makineri sprucojeni me pompën e suvasë. Aplikimi i llaçit sprucues bëhet direkt mbi bazament duke mbuluar plotësisht sipërfaqen në një trashësi 5 mm dhe duke krijuar një sipërfaqe të ashpër. Koha e ndënjes përpara aplikimit të llaçit mbushës: min. 3 javë. Shtresa e llaçit sprucues nuk mund të quhet shtresë suvatimi.

### Magazinimi

---

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti.

### Udhëzime teknike dhe ligjore

---

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

### Këshilla të përgjithshme

---

Kjo skedë teknike anulon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit ([www.roefix.com](http://www.roefix.com)), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.